

“Ta pranojmë dashurinë e Zotit të mishëruar për ne e të angazhohemi, me hirin e Tij, ta bëjmë botën tonë më njerëzore, më të denjë për fëmijët e sotëm e të nesërm”.

PAPA FRANÇESKU
KRISHTLINDJE 2017



Kisha e Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 10 DHJETOR 2017 Çmimi 30 lekë



PËR SHUMË VJET KRISHTLINDJEN !

Për shumë vjet Krishtlindjen!

Predikimi i Sh.T. Imzot George Frendo
në Meshën e Natës së Krishtlindjes në
Katedralen e shën Palit në Tiranë. *faqe 3*

Predikimi i Sh.T. Imzot George Frendo
në Meshën e Ditës së Krishtlindjes në
Katedralen e shën Palit në Tiranë *faqe 4*

Urbi et Orbi. Papa: ta bëjmë
botën më njerëzore e më të
denjë për fëmijët *faqe 5*

Papës i dhurohet Shpella e
Betlehemit më e vogël në botë *faqe 6*

Mesazhi i Ipeshkëvinjëve Katolikë
për Krishtlindje 2017 *faqe 7*

Krishtlindje!!!
Për shumë mot Krishtlindjen!

Nga Dom Marjan LUMÇI *faqe 7*

Kryqi i mirënjohjes në Katedrale
Nga Ferdinand NDOCAJ *faqe 8*

Muaji tetor dhe vizita pastorale e
Arqipeshkvit Monsinjor George
Frendo O.P

Nga P. Andrzej MICHON, C.Ss.R. *faqe 9*

Papa Françesku e të rinjtë
Nga Dom Arjan DODAJ *faqe 11*

25 vite prani e Motrave Sale-
ziane në Tiranë
Nga Motër Teuta BUKA *faqe 12*

Kalendari Liturgjik Janar 2017

Vizita e Dijetarëve
Mateu 2, 1-12



Pasi Jezusi leu në Betlehemin e Judesë, në kohën e mbretit Herod, kur qe, prej Lindjes ia behën në Jerusalem disa Dijetarë, e pyetën: “Ku është foshnja e lindur, që do të bëhet mbreti i judenjve. Sepse e pamë yllin e tij duke lindur dhe erdhëm t’i shprehim nderimet tona.”

Mbreti Herod, posa i dëgjoi këto fjalë, u shqetësua vetë e me të edhe mbarë Jerusalemi. I bashkoi të gjithë kryepriiftërinjtë e skribët e popullit dhe i pyeti ku duhet të lindë Mesia. Ata i përgjigjën: “Në Betlehemin e Judesë, sepse kështu ka shkruar profeti: *“E ti, o Betlehem tokë e Judës, ti nuk je kurrsesi më i parëndësishmi ndër qytetet princore të Judës, sepse prej teje do të dalë prijësi, që do ta udhëheqë popullin tim, Izraelin.”*

Atëherë Herodi i thirri fshehtazi Dijetarët dhe me kujdes mori hetime prej sish rreth kohës kur u ishte dukur ylli. Pastaj i dërgoi në Betlehem duke u thënë: “Shkoni dhe bëni me kujdes kërkime rreth fëmijës. Kur ta gjeni, më lajmëroni që edhe vetë të vij e t’i shpreh nderimet e mia.”

Ata, si e dëgjuan mbretin, u nisën. Dhe ja, ylli që kishin parë në lindjen e tij, u shkante përpara derisa s’zuri vend aty ku ishte fëmija. Ata, kur e panë yllin, u bënë shend e verë. E, si hynë në shtëpi, panë fëmijën me Marinë, t’ëmën e tij, ranë përmbys dhe i shprehën nderimet e tyre. Pastaj hapën thesaret e veta e i dhuruan: ar, kem e mirrnë. Të mësuar në ëndërr prej Hyjit të mos ktheheshin te Herodi, u kthyen një rrugë tjetër në vendin e vet.

1 janar – VIRGJËRA MARI HYJLINDËSE

2 janar – Sh. Bazili dhe Shën Gregori Naziancen ipeshkvinj dhe mësues të Kishës

3 janar – Emri Tejet i Shenjtë i Jezusit

6 janar - DËFTIMI I ZOTIT

7 janar – E DJELA E DYTË PAS KRISHTLINDJES Shën Rajmondi nga Penjaforti meshtar

10 janar – Pagëzimi i Zotit

13 janar – Shën Hilari ipeshkëv dhe mësues i Kishës

14 janar – E DJELA II GJATË VITIT

16 janar – Shën Donati martir

17 janar - Shën Antoni abat

20 janar – Shën Fabiani papë dhe martir dhe Sh. Sebastiani martir

21 janar – E DJELA E III GJATË VITIT Sh. Anjeza virgjër dhe martire

22 janar – Sh. Vinçensi djakon dhe martir

24 janar – Sh. Françesku i Salës ipeshkëv dhe mësues i Kishës

25 janar – KTHIMI I SH. PALIT APOSTULL

26 janar – Sh. Timoteu dhe Titi ipeshkvinj

27 janar – Sh. Anxhela Meriçi virgjër

28 janar – E DJELA IV GJATË VITIT Sh. Toma i Akuinit meshtar dhe mësues i Kishës

31 janar - Sh.Gjon Bosko meshtar.



Drejtor i përgjithshëm:

Imzot George Frendo

Kryeredaktor:

D. Marjan Lumçi

Sekretar:

Ferdinand Ndocaj

Redaksia:

Kolec Çefa
Ana Stakaj
Zef Skanjeti
Elidon Dodaj

Grafika:

Pjerin Sheldija

Foto: Pici

Adresa:

Katedralja e Shën Palit,

Bulevardi Zhan D’Ark,

Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

Për shumë vjet Krishtlindjen!



Predikimi i Sh.T. Imzot George Frenzo në Meshën e Natës së Krishtlindjes në Katedralen e shën Palit në Tiranë.

Në këtë natë keni lërë shtëpitë tuaja, sepse keni dashur të kremtoni me gëzim lindjen e një foshnjeje të veçantë. Nuk ju mjaftonte të kremtonit këtë ngjarje me familjet tuaja, por keni dashur ta kremtoni me një familje shumë më të madhe, një mori që u bë familje në saje të kësaj foshnjeje. Dhe është një foshnje që ka lindur në kushte shumë të çuditshme.

Në vendin e lindjes së tij ka shumë lëvizje, sepse po bëhet regjistrimi i popullsisë. Por jo në këtë orë. Është natë. Në këtë orë të gjithë janë në gjumë. Por janë disa persona që janë ende zgjuar. Janë Jozefi dhe Maria, e cila sapo ka lindur këtë djalë. Pas tetëditësh do t'i japin emrin "Jezus", që do të thotë "Shpëtimtar". Dhe janë zgjuar edhe disa barinj në këtë fshat, të cilët në këtë orë janë duke ruajtur grigjën e tyre. Pra, kanë fatin të jenë të parët që marrin lajmin e lindjes së këtij djali.

Por më i çuditshëm është fakti se ky djalë, jo vetëm lind jashtë shtëpisë së prindërve në fshatin e Nazaretit, por lind në një fshat të vogël, Betlehem, dhe në një varfëri ekstreme, në një shpellë. Çfarë shohim në këtë shpellë? Shohim këtë foshnje të brishtë. Në fytyrën e tij shohim fytyrën e dinjitetit e çdo njeriu. Afër tij janë prindërit e tij, Maria dhe Jozefi. Pra është një familje. Në fotografinë e kësaj familjeje shohim fotografinë e çdo familjeje të krishterë. Ja pse festa e sotme është një festë shumë e madhe dhe shumë e veçantë. Sepse sot është festa e njeriut. Sot është festa e familjes.

FESTA E NJERIUT

Le t'i afrohem kësaj foshnjeje, t'i rrimë afër, sepse ai na fton të mësojmë nga ai. Shumë njerëz sot janë tepër mendjemëdhën timer dhe na përqeshin kur themi se duhet të mësojmë nga një foshnje. Por ky djalë na mëson pikërisht atë që këta njerëz nuk duan të dëgjojnë.

Së pari, ky djalë na mëson dinjitetin e njeriut, e çdo njeriu. Në fytyrën e Jezusit fëmijë shohim fytyrën e çdo njeriu, mashkull ose femër, i bardhë ose i zi, i ditur ose i pashkolluar. Me ardhjen e tij në botë Jezusi në këtë natë ka shtruar themelet për një dinjitet të ri për njeriun. Nga grazhdi Jezusi na urdhëron të respektojmë dinjitetin dhe të drejtat e çdo njeriu. Prandaj njeriu s'ka nevojë të afrojë një deputet që t'i ofrohet puna, s'ka nevojë të paguajë një kirurg në një spital publik që të bëjë një operacion, s'ka nevojë të korruptojë një gjyqtar që të marrë vendimin e drejtë në gjykatë, s'ka nevojë të pijë drogë që të gjejë gëzim, as ka nevojë të lypë nëpër rrugë që të fitojë bukën e ditës.

Në mes të shekullit 18, shkrimtari i famshëm anglez, Charles Dickens, duke shikuar gjendjen e shumë fëmijëve në epokën viktoriane të Anglisë, ka shkruar shumë romane nëpërmjet të cilëve ka dashur të tërheqë vëmendjen e shoqërisë angleze të asaj kohe drejt situatës së fëmijëve në atë kohë. Ndoshta romani më i njohur është *Oliver Twist*, ku përshkruan situatën e jetimëve në atë kohë. Çfarë do të thoshte Charles Dickens sot duke shikuar që, në këtë botë që mburret me përparimet ekonomike dhe industriale, në shumë vende të botës, shumë fëmijë detyrohen të punojnë për të mbështetur familjen?

Foshnja Jezus na kujton se edhe fëmijët kanë të drejtat e tyre: të drejtën për jetën, për arsimin, për strehimin. Çfarë dotë thoshte Charles Dickens duke shikuar shumë fëmijë sot, këtu në Shqipëri, të cilëve u mohohet mundësia të arsimohen sepse nuk guxojnë të dalin nga shtëpia e tyre? Jeta e tyre nuk është e sigurtë, jetojnë gjithmonë në frikë, në rrezik, janë të kërcënuar. Ai që i kërcënon është terrorist. Nuk meriton asnjë titull tjetër përveç këtij: terrorist.

Sot shohim Jezusin fëmijë të shtrirë në një grazhd, në varfëri ekstreme për shkak të egoizmit të atyre që nuk i kanë ofruar shtrehim nënës së tij në orët e fundit të shtatzanisë së saj. Në grazhd Jezusi në këtë orë po qan duke treguar

solidaritetin e tij me shumë fëmijë që, në këtë orë, janë duke fjetur jashtë në të ftohtë; me ata fëmijë që janë shtruar në krevat pa ngrënë as një grimcë buke; me ata fëmijë që, para se të jenë shtrirë në krevat, kanë parë babanë e tyre duke hyrë në shtëpi i dehur e pastaj duke rrahur nënën dhe vetë fëmijët. Ja historia tragjike e shumë fëmijëve. E ku është Charles Dickens për të shkruar historinë e tyre? Por ne duhet të jemi gjithmonë mbrojtës të të pambrojturve, zë për ata që janë pa zë. Sepse besojmë në dinjitetin e njeriut, të zbuluar sonte në fytyrën e këtij djali të brishtë.

FESTA E FAMILJES

Sot është festa e familjes. Në atë shpellë në Betlehem shohim një familje. Është një familje e thjeshtë, e varfër, por shumë e lumtur. Asnjëri nuk e dëgjon dënesën e kësaj foshnjeje, përveç prindërve, njerëz të thjeshtë. Nuk e dëgjon Herodi, në pallatin e tij; as e dëgjojnë priftërinjt e popullit, në tempullin e tyre. Por e dëgjojnë i ati, Jozefi, një marangoz, dhe e ëma, Maria, shtëpiake. Megjithatë sonte jemi të ftuar t'i afrohem grazhdit ku është shtrirë Jezusi, e duke e shikuar të rrethuar nga prindërit, të mësojmë nga kjo familje.

Sot flasim shumë për të drejtat e disa kategorive personash, por nganjëherë duke harruar të drejtat e fëmijëve. Është shtiracake ajo shoqëri që flet për abortin sikur të ishte një e drejtë e gruas, duke harruar se edhe fetusit e ka të drejtë për jetën. Ose flet për divorcin sikur të ishte një e drejtë themelore, duke harruar se edhe fëmija ka të drejtë të rritet brenda një bërthame familjare të qëndrueshme. Ose shumë vende që, në emrin e përparimit, miratojnë martesën homoseksuale, duke harruar të drejtën e fëmijës që të rritet në një bashkësi heteroseksuale dhe të ketë një baba e një nënë.

Në një fjalim të bukur që bëri Presidenti i Republikës Z. Ilir Meta para disa javësh, ai tha: "Problemet ekonomike dhe papunësia,



grindjet, përplasjet dhe dhuna në familje provokojnë çdo ditë divorce dhe krim. Divorci dhe krimi shkatërrojnë themelet e familjes. ... Sa më e shëndetshme të jetë familja jonë ... aq më shumë fëmijë të lumtur do rrisim në mjediset tona. Kujdesi për familjen është para së gjithash përkushtim për fëmijët tanë, dhe për të ardhmen e vendit tonë". Janë fjalë që na nxisin të rizbulojmë bukurinë e jetës familjare, që gjen lumturinë në atë dashuri

që shprehet në besnikëri ndaj njëri-tjetrit, në qëndrueshmëri deri në vdekje, dhe në përkushtim për fëmijët.

Të dashur vëllezër dhe motra, kjo është nata në të cilën bota ftohet të dëgjojë dënesën e Jezusit. Por dënesa e tij përzihet me një buzëqeshje. Po, ai na buzëqesh, dhe buzëqeshja që ai i drejton secilit prej nesh tregon pastërtinë e syve të tij. Po, sytë e Jezusit janë të pastër, të kthjellët. Ai nuk përdor syze të

errëta. Na shikon pa paragjykime. Të gjithë jemi shumë të bukur para syve të tij. Le të mësojmë, nga shikimi i tij, si të shikojmë njëri-tjetrin. T'u japim dorën atyre të cilëve ua kemi mohuar deri tani.

Kemi zbuluar Krishtin. Kemi gjetur një rrugë të re që na çon drejt gëzimit të vërtetë. Ky është gëzimi ynë sot. Gëzimi që tregohet në këtë fëmijë të brishtë. Ky është urimi im për ju në këtë natë. Gëzuar Krishtlindjen! Rroftë Jezusi fëmijë.

Predikimi i Sh.T. Imzot George Frendo në Meshën e Ditës së Krishtlindjes në Katedralen e shën Palit në Tiranë

Personalisht nuk e di çfarë do të thotë të jesh hebre ose palestinez, amerikan ose korean, sepse nuk jam as hebre as palestinez, as amerikan as korean. Por unë e di kush jam: jam njeri i krishterë. Çdo gjë tjetër s'ka rëndësi fare për mua.

Dhe festa e sotme na zbulon çfarë do të thotë të jesh i krishterë. Nuk do të thotë të jesh domosdoshmërisht një person i pasur ose në një pozitë të rëndësishme në shoqëri. Por të jesh i krishterë do të thotë të pranosh përgjegjësi për të shpallur në botë mesazhin që neve na u zbulua sot në një foshnje, me emër Jezus. Ky mesazh është dashuria, vëllazëria, drejtësia, paqja, solidariteti. Ky është lajmi i mirë që sot na u dëftua neve me lindjen e Jezusit.

KUSH ËSHTË KY DJALË?

Një nga këngët angleze për Krishtlindje që më pëlqen më shumë quhet *What child is this?* – Kush është ky fëmijë? Dhe kjo është pyetja që duhet të bëjmë të gjithë ne në këtë ditë: Kush është ky fëmijë?

Le të depërtojmë më thellësisht në domethënien e misterit që po shpallim dhe po kremtojmë me shumë gëzim sot. Imagjinojmë se jemi atje, në atë shpellë në Betlehem, në praninë e Marisë dhe Jozefit dhe të barinjve. Një heshtje totale, e prishur vetëm nga këngët e engjëjve, që këndojnë: *Lavdi Hyjit ... dhe paqe njerëzve vullnetmirë*. Para syve tanë shohim grazhdin, ku po shtrihet foshnja e sapolindur. Nga pikëpamja e jashtme, nuk dallohet nga një foshnje tjetër. Një foshnjë e brishtë, që varet krejtësisht nga të tjerët. Por pasi pyesim kush është, mbetemi gojë hapur kur dëgjojmë përgjigjen. Është ai për të cilin thuhet, në *Besoje* që pas pak do të themi së bashku, se *nëpërmjet tij janë krijuar të gjitha sendet*. Është krijuesi. Është e pabesueshme se si tani e shohim në këtë formë, një foshnje e brishtë, dhe e lindur në një varfëri ekstreme.

Gjithashtu, në *Besoje* do të themi: *Ai, për ne njerëzit dhe për shpëtimin tonë, zbriti prej qiellit*. Pra nuk është rastësisht se ai tani gjendet në këtë formë të mjerë. Dhe vazhdojmë: *U mishërua për virtyt të Shpirtit Shenjt, në kraharonin e virgjëres Mari, dhe u bë njeri*. "U bë njeri": ja misteri i madh që sot na detyron të shkojmë në shpellën e Betlehemit e të biem në gjunj para këtij djali të sapolindur. Biri i Hyjit, Krijuesi, që u bë njeri. Madje Shën Gjon Ungjilltar nuk thotë *u bë njeri*, por thotë: *u bë mish*, për të theksuar

faktin se tani ka marrë natyrën tonë, krejt si ne, me të gjitha dobësitë tona, me përjashtim vetëm të mëkatit.

Erdhi për të na shpëtuar, jo për të na dënuar. Jemi ne që dënojmë vetvetem kur i lejojmë vetes të bëhemi viktima egoizmi, mendjemadhësie, lakmie, ambicieje, hakmarrjeje, grindjeje. Nga të gjitha këto Jezusi na ka shpëtuar. Dhe nëse ende jemi viktima e këtyre veseve, kjo do të thotë se ende nuk e kemi pranuar Jezusin si Shpëtimtar.

Erdhi për të mbrojtur viktimat e padrejtësisë. Shikojeni në varfëri ekstreme. Sepse që nga fillimi i jetës së tij si njeri ka dashur të bashkohej me të varfrit. Që nga fillimi i jetës së tij u bë viktimitë e egoizmit që refuzoi të hapë dyert për një nënë në orët e fundit të shtatzanisë së saj. U bë viktimitë e ambicies dhe xhelozisë së Herodit, që e kërkonte për ta vvarë.

Erdhi për të ndërtuar një shoqëri të re, mbi themelet e një revolucioni të ri: është revolucioni i dashurisë, për të cilën nuk ka hebre ose grek, mashkull ose femër, ilirë ose skllavë. Dhe duke na nxitur për solidaritet, Jezusi na kujton se tani, në saje të ardhjes së tij në botë, i përkasim një familjeje më të madhe, familjes njerëzore, që do të thotë se duhet t'i jap dorën çdo njeriu, duke i ofruar dashurinë tonë.

PASURIA E GËZIMIT

Të jesh i krishterë do të thotë gjithashtu të përjetosh gëzim në thjeshtësi, edhe nëse jeton në varfëri. Para shumë vitësh kam kaluar Krishtlindjen në Brazil, në një *favela*. Domethënë një zonë plotë me barake, mes njerëzish shumë të varfër. Por më bëri shumë përshtypje buzëqeshja e tyre. Dhe ata më kanë konfirmuar se gëzimin nuk e gjejmë në supermarket, në asnjë treg. Nuk shitet, nuk blihet.

Në ditët e fundit të kohës së Ardhjes Kisha na ka paraqitur Marinë, vajzën e Nazaretit. Ne e quajmë "Zoja Mari", por në jetën e saj asnjëri nuk e quante "Zonjë". Ishte thjesht një Mari, një vajzë e thjeshtë nga Nazareti, një fshat i përvuajtur, pa asnjë rëndësi. Një vajzë e re, që mbeti shtatzënë në një mënyrë të mrekullueshme. Hyn në shtëpinë e dy pleqve me emër Elizabeta dhe Zakaria. Edhe Elizabeta është shtatzënë. Por me fjalët përshëndetëse të Marisë, foshnja që ishte në kraharonin e Elizabetës kërcen prej gëzimit; dhe vetë Maria thotë: "Shpirti im me hare i brohoret Hyjit". Në natën e lindjes së Jezusit, barinj të Betlehemit lënë grigjat e tyre dhe me gëzim vrapojnë drejt shpellës për t'u takuar me Jezusin. Dyzet ditë pas lindjes, Jezusi kushtohet në Tempullin e Jerusalemit. Atje e pret



një plak, me emër Simon. Plot gëzim, Simoni thotë se tani nuk ka frikë të vdesë: dëshira e tij e përhershme tani u plotësua, sepse ka pasur fat të shohë Jezusin dhe ta mbajë në duart e tij.

Njerëzit e varfër që kam takuar në barake në Brazil në ditën e Krishtlindjes përjetonin këtë gëzim. Ishin njerëz të thjeshtë, por të matur në besimin e tyre. Nuk ishin njerëz që përfitonin nga besimi i tyre dhe nga Kisha (si, fatkeqësisht, ndodh ndonjëherë, si ata që thonë: Jam katolik, prandaj kam të drejtë të gjej punë tek ju; kam të drejtë të marr një bursë studimi nga ju). Përkundrazi, ishin njerëz që e dinin mirë që duhet t'i shërbejnë Zotit dhe Kishës, dhe jo të shërbëhen nga Kisha.

Mos më keqkuptoni. Nuk dua të them se varfëria shoqërore është diçka e mirë. Varfëria shoqërore është gjithmonë diçka negative, dhe i krishteri duhet të luftojë kundër varfërisë shoqërore, që është shenjë se plani i Zotit nuk po realizohet dhe urdhri i Zotit që t'i ndihmojmë të varfrit nuk po zbatohet. I krishteri duhet të luftojë kundër varfërisë në shoqëri. Oh, sikur të vijë një ditë kur varfëria do të zhduket krejtësisht!

Ata që, gjatë kohës së Ardhjes, janë përpjekur të bënin diçka për të ndihmuar një të varfër, kanë çdo arsye të ndihen të lumtur në këtë ditë. Ata që, gjatë këtyre ditëve, kanë pasur fat të krijojnë një buzëqeshje tek fytyra e një personi të braktisur ose të mënjanuar, kanë çdo të drejtë sot të ndihen në shoqërinë e Marisë dhe Jozefit dhe të barinjve afër grazhdit të Jezusit. Atyre Jezusi fëmijë po u buzëqesh në grazhd, atyre ai u komunikon gëzimin e tij. Nga ai ne mësojmë si të tregojmë dashurinë tonë nëpërmjet një buzëqeshjeje, sepse "të buzëqeshësh do të thotë të shohësh të tjerët me sytë e Zotit".

Para se të mbaroj, dëshiroj të bëj një rrëfim. A doni të dini cila është kënaqësia ime më e



madhe si prift? Sa herë që bëj të buzëqeshë një personi që ka ardhur tek unë me një problem dhe unë e kam ndihmuar. Dhe a doni të dini cili është zhgënjimi im më i madh si prift? Sa herë që jam përpjekur të pajtoj dy persona dhe nuk kam patur sukses, sepse kanë parapëlqyer të jetojnë në vdekjen e urrejtjes sesa në jetën e dashurisë.

Sot kjo Kishë është plot me besimtarë. Pse nuk është aq plot çdo të diel? Nuk mjafton ta lavdërosh Zotin kur je vetëm; ai të pret e të fton ta takosh çdo ditë të diel bashkë me besimtarët e tjerë. Sepse Ai na ka bërë pjesëtarë të një familjeje të madhe.

Fort të dashur, prania jonë në këtë Tempull sot tregon se është e mundshme të jetojmë së bashku, me dallimet që mund të ekzistojnë mes

nesh. Kush na ka bashkuar? Jo një person me pushtet të madh, para të cilit shumë e përkulin kokën, as një intelektual në praninë e të cilit çdo njeri i bën veshët katër. Është një foshnjë e thjeshtë. Dhe pse na ka bashkuar? Për ta lavdëruar së bashku dhe për ta ndarë gëzimin tonë me njëri-tjetrin. Sot Jezusi ka ndezur një zjarr mbi tokë. Është zjarri i dashurisë. Le ta lëmë vetveten të digjemi në këtë zjarr, që bota të kuptojë se ka një zjarr të ndryshëm nga zjarri i bombave. Zjarri i bombave dëmton e shkatërron. Zjarri i dashurisë pastron e ndërton. Dilni në rrugët e botës e shpallni këtë lajm: Sot ka lindur dashuria, ka lindur gëzimi, ka lindur paqja e njerëzve vullnetmirë! Aleluja! Gëzuar Krishtlindjen!

Urbi et Orbi.

Papa: ta bëjmë botën më njerëzore e më të denjë për fëmijët

Në Solemnitetin e Lindjes së Zotit, nga Lozha Qendrore e Bazilikës së Vatikanit, Ati i Shenjtë u drejtoi Mesazhin tradicional besimtarëve të pranishëm në Sheshin e Shën Pjetrit dhe gjithë atyre, që e ndoqën përmes radios e televizionit, duke dhënë edhe bekimin Urbi et Orbi.

Të dashur vëllezër e motra, gëzuar Krishtlindjen!

Në Betlehem, nga Virgjëra Mari, lindi Jezusi. Ai nuk lindi përmes vullnetit njerëzor, ishte dhuratë e dashurisë së Zotit Atë, që aq fort e desh botën, sa të jepte një të vetmin Birin e vet, që kushdo beson në Të, të mos humbasë, por të ketë jetën e pasosur (Gjn 3,16).

Kjo ngjarje përtërihet sot në Kishën, shtegtarë në botë: feja e popullit të krishterë rijeton, në liturgjinë e Krishtlindjes, misterin e Zotit

që vjen, që merr natyrën tonë të vdekshme, që bëhet i vogël e i varfër për të na shpëtuar. E kjo na mbush me emocion, sepse tejet e madhe është dashuria e Atit tonë.

Të parët që e panë lavdinë e përvuajtur të Shëlbuesit, pas Marisë e Jozefit, ishin barinjtë e Betlehemit. E njohën shenjën që u dhanë engjëjt dhe e adhuruan Foshnjën. Këta njerëz të përvuajtur, por të pagjumë, janë shembull për besimtarët e çdo kohe që, përballë misterit të Jezusit, nuk shkandullohen nga varfëria e Tij, por, ashtu si Maria, besojnë në fjalën e Zotit dhe e kundrojnë me sy të thjeshtë lumninë e tij. Përballë misterit të Fjalës së mishëruar, të krishterët e çdo vendi shpallin, me fjalët e Shën Gjonit Ungjilltar: "E kundruam lavdinë e Tij, lavdi si e Birit të vetëm, që vjen nga Ati plot me hir e vërtetësi" (1,14).

Sot, ndërsa mbi botën fryjnë erëra lufte e një model zhvillimi tashmë i vjetëruar, vijon të prodhojë degradim njerëzor, shoqëror e ambiental, Krishtlindja na kujton shenjën e Fëmijës, për ta pranuar në fytyrat e fëmijëve, posaçërisht të atyre, për të cilët, ashtu si për Jezusin, "nuk ka vend në bujtinë" (Lk 2,7)

E shikojmë Jezusin në fëmijët e Lindjes së Mesme, që vijojnë të vuajnë për shkak të thellimit të tensioneve ndërmjet izraelitëve e palestinezëve. Në këtë ditë feste i kërkojmë Zotit, në lutje, paqen për Jeruzalemin e për gjithë Tokën Shenjte. Lutemi që ndërmjet palëve të ketë epërsi vullneti për të rifilluar dialogun e të mund të arrihet, më në fund, në një marrëveshje që krijon kushtet për bashkëjetesë ndërmjet dy shteteve brenda kufijve të konkorduar ndërmjet tyre e të njohura ndërkombëtarisht. Zoti i mbështetët

edhe ata që, në bashkësinë ndërkombëtare, frymëzohen nga vullneti i mirë për ta ndihmuar këtë tokë të martirizuar që të gjejë, pavarësisht nga pengesat e rënda, harmoninë, drejtësinë e sigurinë e pritur prej shumë kohe.

E shikojmë Jezusin në fytyrat e fëmijëve sorianë, të cilëve u duken akoma shenjat e luftës, që e gjakosi këto vite vendin. Uroj që në Siri të rikthehet, më në fund, respektimi i dinjitetit të çdo njeriu, përmes angazhimit të përbashkët për rindërtimin e indit shoqëror, pavarësisht nga përkatësia etnike e fetare.

E shikojmë Krishtin Fëmijë në Irakun, ende të plagosur e të përçarë nga ndeshjet e këtyre pesëmbëdhjetë vjetëve të fundit, e në fëmijët e Jemenit, ku vijon konflikti i harruar nga një pjesë e mirë e botës, me pasoja të rënda humanitare mbi popullsinë, që vuan nga uria e nga përhapja e sëmundjeve.

E shikojmë Jezusin në fëmijët e Afrikës, posaçërisht në ata që vuajnë në Sudanin Jugor, në Somali, në Burundi, në Republikën Demokratike të Kongos, në Republikën Qendrafrikane e në Nigeri.

E shikojmë Jezusin në fëmijët e mbarë botës, atje ku paqja e siguria kërcënohen nga rreziku i tensioneve dhe i konflikteve të reja. Lutemi që në gadishullin korean të kapërcehen kundërvëniet e të thellohet besimi reciprok në dobi të mbarë botës.

Krishtit Fëmijë ia besojmë Venezuelën, që të mund të rifillojë një ballafaqim i qetë ndërmjet anëtarëve të shoqërisë, në dobi të mbarë popullit të dashur venezuelan. E shikojmë Jezusin në fëmijët që, së bashku me familjet e tyre, pësojnë dhunën e konfliktit në Ukrainë, si dhe pasojat e tij të rënda humanitare e lutemi që Zoti t'i japë sa më parë paqen këtij vendi të dashur.



E shikojmë Krishtin Fëmijë në fëmijët, prindërit e të cilëve nuk kanë punë e nuk arrijnë t'u sigurojnë bijve të tyre një ardhmëri të sigurt e të qetë.

E në ata, të cilëve iu rrëmbye fëmijëria, të detyruar, siç janë, të punojnë që në moshë të njomë, ose të mobilizuar ushtarë nga mercenarë pa skrupuj.

E shikojmë Jezusin në një mori fëmijësh, të detyruar t'i lënë vendet e tyre, të shtegtojnë të vetëm, në kushte çnjerëzore, pre e lehtë e trafikantëve të qenieve njerëzore. Përmes syve të tyre shikojmë dramën e shumë emigrantëve të detyruar, që rrezikojnë deri jetën, për të përballuar udhëtime kapitëse, të cilat nganjëherë përfundojnë në tragjedi. E rishikoj Jezusin në fëmijët, që i takova gjatë shtegtimimit tim të

fundit në Mianmar e Bangladesh, e uroj që bashkësia ndërkombëtare të vijojë të përpiqet që dinjiteti i pakicave të pranishme në rajon të mbrohet me kujdesin e duhur. Jezusi e njeh mirë dhembjen e mosmikpritjes dhe raskapitjen e njeriut që nuk ka vend ku të mbështesë kokën. Zemra jonë të mos mbyllet, si u mbyllën shtëpitë e Betlehemit!

Të dashur vëllezër e motra,

Edhe ne na tregohet shenja e Krishtlindjes: “një fëmijë i mbështjellë në fasha...” (Lk 2,12). Ashtu si Virgjëra Mari e Shën Jozefi e si barinjët e Betlehemit, në Krishtin fëmijë, ta pranojmë dashurinë e Zotit të mishëruar për ne e të angazhohemi, me hirin e Tij, ta bëjmë botën tonë më njerëzore, më të denjë për fëmijët e sotëm e të nesërm.

Papës i dhurohet Shpella e Betlehemit më e vogël në botë

Një Shpellë e vogël Betlehe - RV

Papës i dhurohet Shpella e Betlehemit më e vogël në botë. Është një kopje e Shpellës së vendosur në Sheshin e Katedrales së Vilnius, e zvogëluar 10.000 herë, e realizuar me një mjet laser. Shpella e Betlehemit, që mund të shikohet vetëm me mikroskop, u shkrua në Librin Guines (Guinness World Records), që botohet çdo vit, që nga 1955-sa e që përmbledh të gjitha rekordet e botës, nga ato natyrore, tek ato njerëzore, duke përzgjedhur më origjinalet. Shpella xhuxhe e Betlehemit u krijua në tri kopje nga qendra kërkimore “LinkMenu fabrikas” e Politeknikut të Vilnius. Një nga këto tri kopje, iu dhurua nga Presidenti i Lituanisë - Papës Françesku, më 22 dhjetorin e kaluar, në prag të Kshndellave.



Mesazhi i Ipeshkëvinjëve Katolikë për Krishtlindje 2017

“Populli që ecte në errësirë pa një dritë të madhe” (Is 9,1)

Krishtlindja është festa e dritës. Për ne Krishti është drita që shkëlqen në errësirë (Gjn 1,5), ai i cili vjen nga drita e Atit për të shndritur errësirën përreth nesh e brenda nesh. Kjo festë është solidariteti i Hyjit me njeriun. Në Krishtlindje Hyji merr mishin njerëzor, ashtu të plagosur e të vuajtur, dhe i jep një dinjitet njeriut, duke përtërirë marrdhënien me të e duke shtruar kështu rrugën e vëllazërimit midis njerëzve. Natën e Krishtlindjes në të gjitha kishat tona do të jehojë fjala e Isaisë profet: “Populli që ecte në errësirë pa një dritë të madhe, për banorët që jetonin në krahinën e hijes së vdekjes zbardhi për ta drita” (Is, 9,1).

Po çfarë është errësira?

Konteksti në të cilin është thënë kjo shprehje na sjell ndërmend shpërnguljen e popullit të Izraelit, skllavërinë e tij, largësinë e tij nga tempulli dhe nga toka e etërve, nëpërkëmbjen dhe rrezikun e shfarosjes, urinë dhe etjen. Janë situata që përsëriten në historinë e njerëzimit e jo vetëm në një popull. Në gjendjen në të cilën jetojmë mund të themi se elementë të kësaj errësire janë të pranishëm edhe në jetën e popujve në kohën e sotshme. Varfëria dhe uria po vret shumë jetë njerëzish, konfliktet e armatosura në shumë anë të globit, terrorizmi me matricë fetare, dukja në horizont e një konflikti nuklear, gjenocidi nëpërmjet abortit, ndarja e familjeve në botën moderne, e shumë dukuri të tjera, duket sikur po e çojnë botën në një drejtim të panjohur.

Po ashtu, në realitetin tonë shqiptar, duket se shumë dukuri errësojnë atë të mirë që çdo ditë, edhe pse në heshtje, hedh farën e saj në jetën tonë. Në shumë anë të Shqipërisë ka varfëri dhe mjerim, sidomos në zonat më periferike

të vendit, në fshatrat e braktisura, por edhe në periferitë e qendrave të mëdha urbane. Shpesh jetohe në minimumin jetik. Kjo ka bërë që rreth 50 % e shqiptarëve, sipas statistikave, të dëshirojnë të ikin nga Shqipëria për një jetë më të mirë e më të dinjitetshme, duke zbrazur kështu kombin. E kjo vjen si pasojë e mungesë së shpresës. Errësira është mungesë shprese. Korrupsioni, pasurimi nëpërmjet kultivimit të lëndëve narkotike, papunësia, etj. bëjnë që hendeku midis të varfërve dhe të pasurve, të fortëve dhe të dobëve, të bëhet gjithnjë e më i madh e të thellohet gjithnjë e më shumë.

Por *errësira* është akoma më shumë se sa kaq. Ajo është mospërgjigja dhe refuzimi i njeriut (Gjn 1,11) ndaj planit të Zotit, i cili do që në tokë të përmbushet ligji i dashurisë midis njerëzve. Errësira është pasojë e zgjedhjeve të shtyra nga egoizmi dhe nga dëshira për pushtet e përfitim me çdo kusht e në kurriz të të tjerëve, e padrejtësive që bëhen çdo ditë prej atyre që mendojnë se kanë pushtet dhe fuqi.

E çfarë është drita?

Drita është prania e Hyjit dhe e çdo gjëje të mirë që ai ka vendosur në zemrën e njeriut dhe në jetën e botës. Është etja për paqe e drejtësi, pasi Mbretëria e Hyjit është mbretëri paqe dhe drejtësie (Rm 14,17). Është shpresa se njeriu mund t’ia dalë dhe se Zoti nuk e braktis. Profeti Isaia duke lexuar historinë me sytë e Hyjit e kupton shumë mirë se Zoti nuk e braktis kurrë popullin e tij dhe se fara e së mirës që ai ka mbjellë në botë (Mt 13,1-9) do të lindë e do të rritet.

Në të njëjtin libër që mbane emrin e Isaisë thuhet: “Thuajuni atyre që i ka lëshuar zemra: “Mbahun! Frikë mos kini! ... sytë do t’u çelen të verbërve veshët e të shurdhërve do të dëgjojnë;

atëherë i shqepi do të kërcejë si dreri gjuha e të pagojit do të shpërthejë në hare, se në shkretëtirë do të burojnë ujërat, përrrenjtë do të rrjedhin nëpër shkretëtirë.” (Is 35, 4 – 6)

Edhe ne si popull ia kemi dalë në shumë raste e përsëri me ndihmën e Zotit dhe angazhimin tonë të sinqertë mund t’ia dalim. Janë bërë shumë gjëra të mira në këto vite në Shqipëri e për këtë duhet të falenderojmë Zotin. Ka shumë burra dhe gra që punojnë seriozisht dhe me përkushtim, qoftë në sektorin publik e qoftë në atë privat. Ne si ipeshkëvinj e inkurajojmë këtë gjë e japim kontributin tonë si bashkësi e krishterë katolike, bashkë me shoqërinë, për të mirën e vendit tonë.

Edhe ne jemi të angazhuar si Kishë, nëpërmjet shumë veprave dioqezane e famullitare, që t’u vijmë në ndihmë familjeve dhe individëve me probleme të varfërisë, të aftësisë së kufizuar, të grave të dhunuara, të familjeve të pamundura. Kemi ndërtuar dhe administrojmë në këto vite shkollat të të gjitha niveleve, kopshte, çerdhe e qendra shëndetësore që ofrojnë një shërbim të rëndësishëm dhe cilësor. Ndoshta mund të bëhet edhe më shumë e ne jemi të gatshëm të angazhohemi që kjo të ndodhë, kudo dhe kurdo të jepen mundësitë.

Por mbi të gjitha jemi të angazhuar që të kumtojmë fjalën e Zotit e cila është një fjalë shprese dhe drite. Krishtlindja është shfaqja e dashurisë së pamasë të Zotit për njeriun dhe për botën: “Hyji aq fort e deshi botën sa që dha Birin e tij një të vetmin (Gjn 3,16)”. E Ai, Krishti, është drita që shndrit në errësirë e bëhet udhërrëfyes për të gjithë ata që ecin në terr dhe në hijen e vdekjes.

Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e Ri 2018
Ipeshkëvinjtë katolikë të Shqipërisë.

Krishtlindje!!!

Për shumë mot Krishtlindjen!

Nga Dom Marjan LUMÇI

Fjala u ba njeri dhe banoi ndër ne!
Atyre që e kanë pranuar u ka dhënë mundësinë dhe pushtetin që të bëhen bij të Hyjit.

Më në fund erdhën Kshndellat!!!

Çfarë festet fantastike. Ishte e vështirë me jetue pa një festë të tillë, pa një lajm të tillë. Mjaft ma duke u marrë e duke ba gjëra që nuk do të dinim ti bënim, skllëvër të disa situatave dhe mendimeve, skllëvër të lekëve, të punës, të familjes, të shëndetit, të raporteve ndërpersonale... **MA NË FUND ERDHËN KSHNDELLAT!**

O Zot, Hyj i Gjithëpushtetshëm, ti që pranove ta dëgjosh britmën e bijve të tu, o Atë

i dashnisë së pafundme, që asnjëherë nuk na ke harruar, o Zot i qiellës e tokës, eja në mesin tonë, eja e na shëlbo!

Ndoshta është e vërtetë se edhe këtë herë po të afrohem me shumë indiferencë, edhe këtë herë gjithçka e kemi bërë gati për festë, por Festuesi mbase na mungon sepse nuk është i mirëpranuar. Kemi vënë shumë drita në Betlehem, e ... mesa di unë atë natë drita nuk ishin të ndezura për ty, kemi zbukuruar shumë Betlehemin përsëri, por... mesa di unë përreth teje ishin vetëm Nëna jote Maria, Rojsi yt Jozefi dhe disa bagëti plehun e të cilëve mbase askush



se kishte pastruar prej ditësh, të kemi mbuluar Betlehemin me erëra të mira dhe dhurata të bukura, por ... mesa di unë përreth teje në atë natë kundërmonte vetëm një erë e keqe stalle të pistë!!! Mesa duket edhe këtë radhë festën të cilën Ti na e përgatitë, ne po ja bëjmë zotave të tjerë, pa pasë kujdes aspak për mirësinë tënde të palodhshme ndaj nesh, pasi kemi shumë punë për të bërë, duam që të dukemi sa me bukur përjashta dhe harrojmë se vendi ku Ti kërkon që ta ndërtojmë Betlehemin është brenda nesh dhe jo thjesht brenda Kishës. Ti na kërkon zemrën, dhe Ty të kemi mbyllur në Tabernakull; Ti na kërkon jetën dhe Ty të kemi lënë në Kishë!

As këtë herë nuk po arrijmë ta kuptojmë se është e nevojshme që të ndalemi pak nga vrapimi i shfrenuar i jetës, që ta shijojmë pak ambëlsinë e pranisë tënde, në mënyrë që më pas të shijomë edhe të gjitha gjërat e bukura që ti na i ke bërë gati që ti shijojmë përgjatë gjithë jetës tonë, por ...Ti ... Zot-Fëmijë na njeh mirë, e din mirë se me çfarë brumi kemi qenë gatuar, të dobët, mëkatnorë, besëprerë; Ti na njeh shumë mirë qysh prej amshimit, Ti na falë, dhe pikërisht për dashninë që ke për ne vjen sërish për të lindur në mesin tonë, për të lindur sërish në zemrat tona.

Por të premtoj se herët ose vonë, ne do ta kuptojmë se Ti je e mira e jonë, se vetëm ti je e mira e jonë. Ki durim me ne, o Zot.

Sonte do të vijmë me të pa, edhe pse ende nuk e besojmë në plotësi atë që sytë tanë do të sodisin, ndoshta vijmë vetëm të shtyrë prej zakonit dhe prej faktit se të gjitha ngasin për me të pa sonte, por ... nëse sonte vijmë, është sepse diçka na intereson në ty, apo jo?

Eja, o Jezus, në zemrën tonë. Kemi nevojë për ty. Mos lejo që kjo festë e ardhjes tënde të kalojë dhe ne përsëri të mos jemi me zemër në takimin me ty.

Ne të dëshirojmë, o Zot, ne duam që të na e shndërrosh zemrën tonë dhe të na e bësh të ngjashme me të tënden, të pasur me dashni, të gatshëm për ta dhënë jetën tonë për Dashni.

Eja, o Jezus, lind përsëri, për në!

Atëherë si do ti dalim përballë Fëmijës – Zot?

Mbase nuk do të kemi gjëra të mira apo të mëdha për ti sjellë Atij, nuk është se kemi bërë ndonjë vepër të madhe për të e për Dashurinë e



Tij, e mbase nuk kemi as guximin që ta shohim në sy drejt për drejtë.

Ashtu sikurse edhe vitin e kaluar, sikurse edhe në vitet që kanë paraprirë, zemra e jonë është e mbushur me hidhërim: kishim dashë me arritë në këtë datë dhe me të thanë: “Qe, o Zot, më ke dhanë 5 talenta, e unë ty tash po të jam 10!”.

Sa shumë shpresë që kishim, sa shumë premtime kishim bërë, sa shumë pritje patëm prej vetvetes, por vetëm tani në fund që afrohet festa e jote e kuptojmë se nuk ka shku gjithçka ashtu sikurse dhe e shpresonim.

Dobësia e jonë dhe plogështia e jonë na çon gjithmonë tek rrënja e mëkatit tonë, prej të cilit ne e kemi shumë të vështirë të dalim e të lirohemi pa ndihmën tënde.

Edhe këtë vit, ndjejmë gjithsesi dhimbje dhe merak për këtë gjë që na ka ndodhë, por ne këtë vit ama besojmë më shumë në Ty.

Qe. Po vijmë tek Ti me duar bosh, por me zemrën plot me lot dhe me sigurinë se Ti gjithmonë na e jep shansin për të rifilluar. Në

këtë mënyrë ne përsëri do të mund ti ri bëjmë premtimet tona, por këtë herë shpresojmë më shumë se me ndihmën tënde ne do ja dalim ti përmbushim ato.

Jemi të sigurt se dhe këtë vit, ti, o Zot Jezus nuk do të na qortosh, por do të jesh i lumtur duke na pranuar kështu siç jemi, me dobësitë tona, me frikat tona, me ankthet tona, me mëkatet tona.

Për këtë jemi të sigurt, sepse në të njëjtën mënyra na ke thënë se kështu ka vepruar edhe Ati yt dhe Ati ynë me djalin plangprishës. Nuk e ka qortuar për asgjë, por, i lumtur e ka pranuar sepse biri i tij pa humbur dhe u gjet, pati vdekur dhe u kthye në jetë.

Pra ardhja e jonë në këtë natë në shpellën e Betlehemit për ne ka një domethënie të re: nuk po vijmë me frikën se mos do na ndëshkosh për mos plotësimin e premtimeve tona, por të lumtur sepse aty je ti, Zoti i jonë që na pret dhe mezi pret që të na pranosh mes krahëve të ty, për të na përqaftuar, për të na puthur, për të na dhënë veshjen e re, për të na bërë të rinj me Dashninë tënde.

Kryqi i mirënjohjes në Katedrale

Nga Ferdinand NDOCAJ

Një grup i vogël prej tre vetësh, me një makinë krejt modeste, mbi një suport nga pas, tërheq Kryqin e madh prej afro tetë metrosh. Është një ngarkesë disi jo e zakonit për shikimin e kalimtarëve, që vetvetishëm i bën të kthejnë kokën duke shoqëruar me sy zhvendosjen e ngadaltë. Makina hyn në derën e oborrit të madh të Katedrales së “Shën Palit”. Së bashku me tre personat, afrohen edhe njerëz të tjerë e bëhen bashkë, për të marrë Kryqin. Duke e mbajtur nga të katërt anët, i drejtohen hy-

rjes. Me të vërtetë është e rëndë pesha e Kryqit të Madh, prandaj shoqëruarit, Njerëzit e Kryqit, shprehen: “Ngado na janë afruar njerëz të mirë, për ta mbajtur sëbashku me ne; pa u thënë asnjë fjalë. Pas Kryqit, vijnë besimtarë nga më të ndryshmit, jo vetëm të krishterë, por edhe hebrej, myslimanë apo edhe nga besime të tjera”... Por “Merreni Kryqin e çojeni në të gjitha kryeqytetet e botës si shenjë e mirënjohjes ndaj Hyjit tonë të gjithëpushtetshëm, për shëlbimin që na ka dhënë nëpër Jezu Krishtin” - janë pikërisht këto fjalët e përsëritura nga Papa Gjon Palit II, të cilat jehojnë vazhdimisht

në veshët e këtyre tre njerëzve. Ata, me jetën e tyre u përkasën këtij misioni të “Kryqit të Mirënjohjes” e për këtë motiv janë Njerëzit e Kryqit. Siç edhe shpjeguan, Kryqi i dedikohet përvjetorit të 2000 të Ringjalljes së Krishtit. Pikërisht nën këtë kuadër historik, Papa Gjon Palit II i pati dhënë bekimin, këtij organizimit katolik laik që e pati origjinën nga Leopoli i Ukrainës së largët. E ndërkohë i vendosur në pjesën qendrore të Kishës Katedrale, pranë elterit të shenjtë Kryqi ka zënë vend, i ngritur nga toka. Si të ishin njoftuar besimtarët njëri pas tjetrit, hyjnë në Katedrale, i afrohen në qetësi Kryqit dhe

bien të gjunjëzuar në adhurim. E për këdo që hyn në hapësirën e Katedrales, sytë vetvetiu shkojnë tek ajo pamje e re, pranë elterit të shenjtë, e zbukuruar me shije nga motër Teuta. Lulet e freskëta, harmonia e ngjyrave të pëlhurës e gjithçka tjetër e kanë bërë pjesë organike të Kishës, sikur të ketë qenë aty përherë. Tre Njerëzit e Kryqit, qëndrojnë çdo çast sëbashku. Tanimë sodisin këtë Katedrale të re për ta. Është i dyzeti vend ku po shkëlin. Për rreth njëzet minuta kanë biseduar me Arqipeshkvin e Dioqezës Imzot George Frendo. Në buzëqeshjen e Imzotit, kanë gjetur jo vetëm mirëseardhjen por edhe simpatinë dhe notat e përgëzimit për këtë nisim të sakrificës me shtrirje të gjatë në kohë. Duke u ndeshur me gjithfarë vështirësish klimatike në katër anët e botës, me mjediset e panjohura, me njerëzit e me vështirësitë e ndryshme duke nisur nga komunikimi, ata çdo zgjidhje të jetës së tyre e kanë lënë t'ua japë ky Kryq i Madh i Mirënjohjes. Fill pas Arqipeshkvit bisedojnë me famullitarin Dom Marjan Lumçi, i cili duke ua hapur të gjitha dyert e shpirtit të Katedrales, u ka lënë të kuptojnë se kjo shenjë mjaft domethënëse, dedikuar 2000-vjetorit të Ringjalljes së Krishtit, sigurisht që mirëpritet edhe nga shqiptarët nën objektivin e përgjithshëm të këtij misioni të "Kryqit të Mirënjohjes", që besimtarët të ndalen vetëm një çast për të menduar mbi të gjitha, dhimbjet e marra mbi vete nga Jezusi, për secilin prej nesh. Është me të vërtetë diçka e bukur të ngjallësh nëpër zemrat e besimtarëve mirënjohjen për Jezusin dhe të kërkosh përforcimin e besimit në Ringjalljen e Tij, madje duke e kërkuar brenda vetes dhuratën e jetës së Pasosur. Ata bëjnë me dije se pelegrinazhi i tyre i Kryqit të Mirënjohjes ka nisur në Ukrainë me ngritjen e Kryqit në qendrën e qytetit të Lembergut, për t'u ndjekur nga kryeqyteti Kiev e më pas Donesku më në lindje. Brenda një periudhe të shkurtë Kryqi u bekuar nga Kardinali katolik Eminenca e Tij Marian Yavorskiy, nga Arqipeshkvi i Kishës Greko-Katolike dhe Peshkopi i Kishave Orthodhokse të Ukrainës. Gjatë kreshmëve të 2006 kryqi udhëtoi dhe përshkoi të gjithë Ukrainën. Vizitoi kisha katolike, ortodokse e protestante duke u bërë i pranishëm në liturgjinë e shenjtë si dhe në netët e gjata të adhurimit. Këtë kryq njerëzit e kanë mbajtur mbi shpatulla nëpër qytete e vende të vogla e të mëdha duke u ndjerë pjesë e Krishtit në "Udhën e Kalvarit". Më 28 maj 2006, në Krakau, Kryqi mori bekimin e kreut të Kishës Katolike Papa Benedikti XVI. Udhëtimet në vendet e lindjes, janë pasuar nga qytetet e veriut të Europës (gjatë 2008) si në Riga e Lituanië, në Talin të Estonisë e pastaj në Helsinki ku budistët kinezë kanë ndihmuar



për ta mbajtur mbi shpatulla e për ta çuar në një Kishë luterane. Në Gjermani (gjatë 2009-ës) fillimisht arriti në Hanover e më vonë në Berlin e pastaj në një sërë qendrash të tjera. Edhe në Francë që nga Parisi, në Lurdë e kudo ku ka shkelur, ka pasur devocion të papërshkrueshëm. Qytete të tjera, në Finlandë, në Norvegji etj. e kanë pritë kryqin me adhurim ashtu si Reikiaviku i Islandës, Amsterdami i Holandës, Brukseli i Belgjikës, Budapesti i Hungarisë apo Bratislava e Slovasisë (2011). Ngado ku ka shkelur Kryqi është mbajtur në krahë nga besimtarët dhe është rrethuar nga adhurimet e lutjet e panumërta. Në të gjitha kryeqytetet Kryqi është bekuar nga Ipeshkvi të...

Kështu pra, "Kryqi i Mirënjohjes", u bë pjesë edhe Katedrales së "Shën Palit në Tiranë". Pas bekimit nga ana e Arqipeshkvit të Dioqezës Tiranë-Durrës Mons. George Frendo, për një javë pa rreshtur besimtarët iu afruan Kryqit në lutjen adhurimit individual. Gjatë liturgjisë një-javore veç të tjerash, në qendër të vëmendjes ka qenë edhe ky "Kryqi i Mirënjohjes", duke pasur parasysh gjithashtu edhe faktin se Shqipëria u bë

vendi i 40 që përshkoi ky Kryq. Interesant për besimtarët ka qenë edhe reflektimi mbi këtë numër 40 që përmban simbolologjinë e vet biblike... kështu numri 40 shfaqet mbi të gjitha tek historia e Noesë, i cili kaloi 40 ditë e dyzet netë në arkë, së bashku me familjen e tij si dhe kafshët që Hyji ia la për t'i mbajtur... Moisiu qëndroi në malin e Sinaï, me Zotin, 40 ditë e 40 netë për të marrë Ligjin... Ndërsa në Ungjillin e Mateut, Jezusi para se të fillonte jetën publike u tërhoq për dyzet ditë në agjërim. Duke praktikuar agjërimin, Ai u ushqye vetëm me Fjalën e Hyjit... 40 janë edhe ditët në të cilat Jezusi i ringjallur i mëson apostujt para se t'u dërgojë Shpirtin Shenjt.

Duke u larguar nga Kryeqyteti i Shqipërisë, ata thanë se përmbyllja e vizitave të Kryqit të Mirënjohjes nëpër kryeqytetet e vendeve të ndryshme, na vë gjithnjë para shpresave se në 2033'shin, burrat e gratë e kryeqyteteve respektive të çdo kombi, të mblidhen e të bashkohen nën këtë kryq të mirënjohjes, për ta nderuar Zotin tonë Jezu Krishtin duke e falënderuar për shëlbimin që na ka sjellë.



Muaji tetor dhe vizita pastorale e Arqipeshkvit MonsinJOR George FrenDO O.P

Nga P. Andrzej MICHON, C.Ss.R.

Muaji tetor ka qënë një nga muajit më të veçantë për famullinë “Shën Gjon Pali II”, në Bathore. Një famulli në periferi të kryeqytetit të Tiranës, në bashkinë e Kamzës. Famullia jonë përgjatë këtij muaji ka përjetuar ngjarje me vërtetë të rëndësishme si vizita e parë pastorale, nën drejtimin e arqipeshkvit Mons. FrenDOS (15-22 tetor), 50 vjetori i Kushtimit ndaj Zotit të dy Motrave të Kongregatës të së Lumes Imelda, Motër Irene Lorenzon dhe Motër Gabriela Marchesini (22 tetor), si dhe festën e Pajtorit të kishës sonë “Shën Gjon Pali II” (22 tetor).

Është sigurisht shumë e veshtirë për ti gjetur fjalët e duhura për ti shkruar, për të përshkruar ngjarjet e këtij muaji, tetor 2017, sepse secili pjesëtarë i famullisë sonë, “Shën Gjon Pali II”, sigurisht që do të ishte shumë i prekur nga emocionet e përjetuara në këtë muaji. Për më shumë kur një pjesë të tyre i ka shprehur edhe Mons. FrenDO, në letrën e tij kur flet dhe përshkruan vizitën e tij në Bathore. Dhe ju kërkojë falje nëse disa ngjarje, disa fragmente përsëriten.

Pjesa më e bukur e këtij muaji ishte padyshim fillimi i vizitës baritore, pastorale të dielën me 15 tetor, kur ne të gjithë besimtarët ishim përpara kishës dhe arqipeshkvi Mons. FrenDO merr kryqin e uth dhe më pas bekoj pjesëtarët e famullisë. Një moment që për ne ishte shumë emocional dhe që sigurisht nuk do ta harrojmë. Pas këtij momenti besimtarët ftohen brenda në kishë dhe përgatiten për Meshën e Shenjtë të së Dielës. Vlen të përmendet që në Meshën e celebruar nga arqipeshkvi Mons. FrenDO ishin të pranishëm delegatë nga Kongregata e Redentoristëve të Shenjtë (C.Ss.R), Kongregatë pjesë e së cilës është edhe famullitari jonë Padre Andrzej Michon (C.Ss.R) si: këshilltari i përgjithshëm Vëlla Xhefri, provinciali spanjoll, provinciali italian si dhe koordinatori i Redentoristëve për Europën, Padre Jacek.

Arqipeshkvi MonsinJOR George FrenDO O.P gjatë vizitës së tij baritore në famullinë “Shën Gjon Pali II”, në Bathore zhvilloj takime të ndryshme gjatë tërë javës duke u takuar me grupin e



ministrantëve, me grupin e Veprimtarisë Katolike të Fëmijëve dhe Adoleshentëve, me Motrat Domenikane të së Lumes Imelda, me fëmijët me aftësi të veçanta, me të sëmurët, me gratë e kurseve të rrobaqepësisë, me fëmijët e Oratorit, me Këshillin Baritor, me të gjithë besimtarët e famullisë, me fëmijët e katekizmit, me katekistat, me punonjësit e famullisë si dhe me komunitetin e Institutit dhe të Kasallës. Unë personalisht kam qënë prezent në shumë nga këto takime dhe më poshtë po ju listoj tre takimet dhe fjalët që mua më kanë goditë:

1. Takimi me Veprimtarinë Katolike të Adoleshentëve, ditën e Dielë, datë 15, pas Meshës së Shenjtë, ku mes një diskutimi goxha të gjallë mes të rinjtëve dhe Mons. FrenDOS, Mons. FrenDO tha “Shpresoj që të jeni një rini sa më aktive, sa më e gjallë” dhe “Jetoni një rini të krishterë”;

2. Takimi me Këshillin Baritor provizor të famullisë, ditën e Mërkurë, datë 18, në orën 17:30, ku Mons. FrenDO tha “Ju si laik zotëroni fuqi. Përdoreni atë” dhe “Sot ka ardhur dita dhe është krijuar mundësia që shqipëtarit të ndihmojë shqiptarin”;

3. Takimi me punonjësitë e famullisë,

ditën e Enjte, me datë 19, në orën 15:30, ku Mons. FrenDO tha “Mendoni dhe besoni që gjithçka që ju e keni bërë, që po bëni dhe që do të bëni, ju nuk po e bëni për veten tuaj apo për famullitarin por po e bëni për Atin tuaj Qiellorë, po e bëni për Zotin.”

Dita e fundit e vizitës baritore ishte data 22 tetor që kishte edhe një program shumë të bukur, sigurisht që fillonte me Meshën e Shenjtë nën drejtimin e arqipeshkvit Mons. FrenDO, meshë në të cilën ishte i pranishëm edhe një delegacion me në krye Ambasadorin e Polonisë në Shqipëri Z. Karol Bahura. Gjatë meshës pati një moment të veçantë bekimi të Motrave Domenikane të së Lumes Imelda që gëzonin 50 vjetorin e Kushtimit të tyre ndaj Zotit, Motër Irene Lorenzon dhe Motër Gabriela Marchesini. Dhe sigurisht një moment festiv në ditën e Pajtorit të kishës sonë “Shën Gjon Pali II”, ku pas meshe vazhonte një program me lojëra të ndryshme shumë argëtuese dhe pak muzikë.

Arqipeshkvi Mons. George FrenDO O.P mbas zgjedhjes së tij si Arqipeshkëv vendosi në stemën e tij shprehjen “Bariu takon delet e tij”, dhe ja një nga tufat e tij, tufa e Bathores e pati mundësinë e veçantë të takimit me Bariun e saj dhe duhet të them që është shumë e lumtur për Bariun e saj.





KOMISIONI BARITOR RINOR TR-DR
dhe Pastoralja e Thirrjes

ARQIDIOQEZA TIRANË-DURRËS
Bulevardi Zhan D'Ark - Tiranë



Papa Françesku e të rinjtë

Simpozium dioqezan për të rinj

Universitet Katolike 'Zoje e Këshillit të Mirë', Tiranë më 9 Dhjetor 2017

Nga Dom Arjan DODAJ

Deri me Papët e mëparshëm, shpesh herë duke ju drejtuar të rinjve u thuhej atyre: "Ju jeni e ardhmja e Kishës!", Papa Françesku këtë shprehje e ka transformuar me "Ju jeni e tashmja e Kishës!". Dhe ka bërë më të qartë perceptimin e një realiteti ekzistencial, që ju jeni Kisha sot, në gjymtyrët e saj më të gjallëruara!

Në njërin nga Twit-et e tij, më saktësisht, më 12 Gusht 2017 shkruante: "Të rinj të dashur, ju jeni shpresa e Kishës. Si e endërroi të ardhmen tuaj?" Për këtë motiv shprese që kanë në ADN-në e tyre të rinjtë, Papa Françesku ka shpallur një Sinod për të rinjtë, që do të fillojë në Tetor 2018, po në të njëjtën kohë në të cilën do të ketë fillim Sinodi i Arqidioqezës sonë.

Në eksperiencën personale kam patur fatin nga Zoti që të mund të përjetoj dhe më nga pranë Pontifikatin e Papa Françeskut. Kujtohem për ditën në të cilën është zgjedhur Papë më 13 Mars 2013. Eksperiencia me të rinjtë prezent që përjetonin në palcë të qenit e tyre në Kishë, pjesë e një trupi që ka një At! Aty ndjehej e gjallë prezenca e një Ati që udhëheq popullin e vet në historinë e shpëtimit, nëpërmjet atyre që sjell, Udhëheqës, Barinj e Etër! E gjithmonë, që në Fillim rinia ka hasur në Papa Françeskun një simpati e përkatësi të veçantë. Ai me prezencën e tij Atnore ka ditur të ketë një komunikim zemër më zemër me të rinjtë, ku duke ju folur me gjuhën më familjare atyre, ka bërë që të perceptonin më thellë gëzimin e të qenit të Krishtit, të qenit Kishë, të qenit Ungjillizues për bashkëmoshatarët e tyre.

Papa Françesku nuk ka frikë të ftojë të rinjtë që të kenë **KURAJON PËR TË RREZIKUAR!**

"Nëse një i ri nuk rrezikon është një i ri i plakur! Ju të rinjtë duhet të rrezikoni në jetën tuaj! Sot duhet të përgatisni të ardhmën! E ardhmja është në duart tuaja... Kisha ka nevojë për Pranverë, më shumë akoma e pranvera është stina e të rinjve!

"KURAJOJA PËR TË KËRKUAR TË VËRTETËN!"

Një ndër format më të para të kurajos që duhet të kemi, është ajo që të pyesim veten: "Po kjo a është normale, apo s'është normale?" KURAJOJA që të kërkosh të vërtetën. A është normale që çdo ditë të rritet një sens indiference? Nuk më intereson çka ju ndodh të tjerëve, indiferencë me miqtë, me të afërmit, në lagje, në punë, në shkollë... etj Është normale që....?

... Nëse pra nuk është normale, unë duhet të përfshihem që kjo të mos ndodhë"



Lini një Shenjë!

Për këtë motiv i fton të jetojn jetën si alternativë unike që kanë për të lënë një shenjë, "Si vajza e re e Nazaretit, si Maria, mund të përmirësoni botën për të lënë një shenjë, që të shënojë Historinë tuaj dhe të shunë të tjerëve."

Kisha dhe shoqëria kanë nevojë për JU. Me afrimitetin tuaj, me kurajon që keni, me ëndërrat dhe idealet tuaja, bien muret e mos mobilizimit, e hapen rrugët që na shtyjnë drejt një bote më të mirë, më të drejtë, më njerëzore.

Për të rinjtë Papa ka kujdesin e tij të veçantë dhe porosinë që na jep secilit prej nesh kur na thotë "dini t'ju flisni zemrës së të rinjve, për ti edukuar në ecjen e jetës" Pasi të rinjtë, po fillojnë *Aventurën e madhe të jetës*, e shpesh mbesin të përfshirë në Labirinthe të sipërfaqësishme, e banalitetit, të suksesit të jashtëm që fsheh boshllëkun e brendshëm, të hipokrizisë që maskon përçarjen midis të dukshmes dhe zemrës.

PAPA dhe Dita Botërore e të Rinjve - DBR

Rio de Janeiro 2013: "SHKONI BËNI DISHEPUJ TË GJITHË POPUJT "

Tre fjalë në veçanti:

- 1) Shkoni
- 2) Pa frikë
- 3) Për të shërbyer

Duke ndjekur këto tre fjalë do të eksperimentoni, që kush ungjillizon është i ungjillizuar, kush transmeton gëzimin e fesë, merr më shumë gëzim!- Për këtë që nuk duhet të kemi frikë të jemi më *bujarë me KRISHTIN*, të dëshmojmë Ungjillin e tij. Të çosh Ungjillin është të çosh fjalën e Hyjit, për të çrrënjësuar të |KEQEN dhe dhunën! Për të shkatëruar muret e egoizmit, e për të ndërtuar një botë të re.

DBR KRAKOW 2016

"Lum të mëshirshmit se do gjejnë Mëshirë!"

Soditja e dëshirave, angazhimeve, pasionit dhe energjisë me të cilën shumë të rinj jetojnë jetën! Kjo është shumë e bukur.

Kjo bukuri vjen kur Jezusi prek zemrën e një të riu, dhe e bën atë të aftë për vepra të mëdha!

VIA CRUCIS :

Nevojë për të rinjtë që nuk duan të jetojnë jetën gjysëm për gjysëm.

Përballë të keqes, vuajtjes, korrupsionit e vetmja përgjigje e dishepullit të Krishtit është DHURATA E VETVETES, në imitim të Jezusit!

Nëse pra një i ri nuk jeton për të shërbyer, atëherë nuk shërben të jetojë.

Nuk kemi ardhur në botë për të vegjetuar, për të bërë jetë divani që të përgjumon, përkundrazi kemi ardhur të bëjmë një shenjë.

Të vendosemi që ta ndërrojmë divanin me një PALË KËPUCË, që bëjnë të ecësh drejt HORIZONTEVE TË REJA, TË AFTË për gëzim!

Koha e sotme, nuk ka nevojë për të rinjë-Divane! "MLODZI KANADOVI..."

Kjo është koha që pranon vetem lojtar TITULLAR NË FUSHË, nuk ka vend për rezerva.

Sot ë rinjtë duhet të jenë protagonistë të historisë! Sepse jeta është e bukur.

Që të mbrojmë dinjitetin tonë, e të mos lejojmë që të tjerët të vendosin për të ardhmen tonë. Jo!

Të ruajmë të MIRËN që kemi marrë. Të bëjmë memorje-kujtesë të takimit me Zotin. Të ruajmë prezencën e Tij, fjalën dhe zërin e Jezusit që na thërret për Emër!

25 vite prani e Motrave Saleziane në Tiranë

Nga Motër Teuta BUKA

Bashkësia motrave saleziane të Tiranës, sapo ka mbyllur festimet për 25 vjetorin e pranisë në Tiranë. Me bashkësinë edukative, që prej 2016, kishim menduar të bënim një ecje duke shënuar disa etapa gjatë vitit.

Festimet filluan me 8 dhjetor vjet, me bekimin e ambienteve të reja të oratorit nga Arqipeshkvi ynë, Imzot George Frendo. Në atë moment i është paraqitur bashkësisë edukative dhe miqve të Qendrës një video me fotomontazhin historik të 25 viteve misioni në Tiranë të motrave tona.

Shtëpia – Qendra jonë i dedikohet shënjtes Maria Mazzarello ndaj gjatë vitit, bashkësia edukative dhe të rinjtë kanë bërë një ecje për të njohur figurën e saj, me leximin kolektiv të librit, “Maria Domenica Mazzarello, një jetë e thjeshtë e plot dashuri”, të motër Maria Pia Giudicit dhe Mara Borsit. Libri i përkthyer në shqip dhe i botuar me 31 janar 2017, u promovua zyrtarisht në fund të qershorit 2017 në një tryezë të rrumbullakët. Kjo tryezë kishte synim ta shikonte jetën e Shënjtes sonë në disa këndvështrime. Një nënë e cila e vë theksin mbi marrëdhëniet familjare të Maria Domenikës, një pedagoge sociologjie që nënvizon profilin e pedagogjisë së saj, dhe një motër saleziane që hedh dritë me profilin e përshtirës së saj, ky event u moderua nga don Gjergj Meta zëdhënës (atëherë) i Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare.

Mbyllja e vitit të 25 u kremtua me 16 dhe 17 nëntor 2017 në praninë e Nuncit apostolik Imzot Charles Brown, Inspektore sonë Motër Mara Tagliaferri e motër Carla Meschinit që ka



qenë edhe themeluesja e kësaj shtëpie në 1992. Bashkë me punonjësit, prindërit, rregulltarët miqtë e qendrës morëm pjesë në një recital që përshkruan pak historinë e kësaj pranie 25 vjeçare. Fokusi i vërtetë ishte rreth mishërimit të karizmës saleziane në realitetin tonë shqiptar. Në këtë spektakël mori pjesë çdo realitet i kësaj Qendre dhe spektakli vetë, me skenografinë, skenarin, koreografinë e gjithçka ishte fryt i punës së përbashkët të krejt bashkësisë edukative.

Të dielën me 17 dhjetor ishim të gjithë bashkë: tri Bashkësitë e motrave saleziane, prindër të motrave shqiptare, fëmijë e të rinj, ish – nxënës të Qendrës për të kremtuar Meshën e falënderimit e cila u kryesua nga Imzot George

Frendo me famulliatirn don Marjan Lumçin dhe bashkëvëllezërit salezian. Në predikimin e tij, Imzot Frendo falënderon Institutin e Bijave të Marisë Ndhimtare për dhuratën e kësaj bashkësie në Dioqezën tonë, falënderon për punën e vyer që kjo bashkësi bën me misionin e vet edukativ dhe baritor mes fëmijëve dhe të rinjve.

Ky 25 vjeçar i parë, që për të gjithë ne, një moment për të reflektuar dhe për të falënderuar për hiret që Zoti ka mbjellë gjatë kësaj ecje jo dhe aq të lehtë, por edhe një mënyrë për të analizuar ecjen e bërë në mënyrë që të përballemi me sfida e së ardhmes me guxim por edhe me largpamësi, që të rinjtë të mund të takojnë gëzimin e vërtetë: Krishtin Jezus!

Ata gjetën fëmijën dhe nënën e tij, ranë në gjunjë dhe e adhuruan

(Shën Maria LIGUORI)

Dijetarët gjejnë një vajzë të varfër me një fëmijë të varfër, të mbështjellë në pelena të varfra... por, kur hynë në grazhd, ndjenë një gëzim që nuk e kishin provuar kurrë më parë. Fëmija Hyj është i gëzueshëm: një shenjë mirësie gëzimtare, me të cilën Ai pret pikërisht ata, frytet e para të Veprës së Tij Shëlbuese. Më tej mbretërit e shenjtë hedhin sytë nga Maria, e cila hesht. Ajo qëndron vazhdimisht e heshtur; e megjithatë, fytyra e saj që pasqyron atë gëzim dhe flladon një butësi qiellore, tregon se, ajo kërkon t'i presë ata me bujari, për t'i falënderuar që ishin të parët që erdhën për të pranuar në Birin e saj atë që është pikërisht: Zoti Tejetlartë i saj... Oh fëmijë, që je i denjë për të gjithë dashurinë; të shoh në këtë grazhd, shtrirë në kashtë, krejt i varfër, krejt i përbuzur. Por besimi më mëson, se ti je Zoti im, i cili zbriti nga Qielli për shpëtimin tim. Unë në Ty njoh Shpëtimtarin tim dhe Zotin tim të Tejetlartë. E shpall këtë për Ty, e megjithatë nuk mund të të dhuroj asgjë. Unë nuk e kam arin e dashurisë, sepse unë dua gjërat e kësaj bote; unë dua vetëm pasionet e mia, megjithëse duhej të të doja Ty, sepse Ti je pafundësisht i denjë për një dashuri të tillë. Nuk e kam kemin e lutjeve, sepse kam jetuar në mënyrë të shkretë pa të menduar Ty. Unë nuk e kam mirrën e flijimit, sepse unë nuk u jam shmangur qejfeve të mjera, duke e mashtruar shumë herë mirësinë Tëndë të pafundme. Çfarë do të ofroj pra? Jezusi im! Unë të ofroj zemrën time, kështu siç është – krejt e zhveshur dhe e ndotur: pranoje dhe shndërroje, sepse Ti erdhe në Tokë, që me



gjakun Tënd, të pastrosh zemrat tona dhe kështu, nga mëkatarë të na kthesh në shenjtër. Ma jep pra këtë ar, kem dhe mirrë, të cilat unë nuk i zotëroj. Ma dhuro arin e Dashurisë Tëndë të Shenjtë; ma dhuro kemin, atë Shpirt të lutjes; ma dhuro mirrën, atë dëshirë dhe forcë, për ta varrosur në mua gjithçka që ty nuk të pëlqen... Oh Virgjër e Shenjtë! Ti i ke pritur dijetarët e përshtirshëm me mirësi të përzemërt, e ke ngopur dëshirën e tyre në përplotësi. Më bëj edhe mua të denjë, që të mirëpritim dhe ngushëlohem prej teje, sepse edhe unë vij sipas shembullit të tyre, për të të vizituar dhe për t'ja ofruar veten Birin tënd.